

Xhemile Selmani, MA¹

UDC:
355.07

**ÇËSHITJA E SIGURISË DHE RREZIQET BASHKËKOHORE NGA
KËRCËNIMET DHE KONCEPTI MBI KËRCËNIMET**

**ПРАШАЊЕТО НА БЕЗБЕДНОСТА И СОВРМЕНИТЕ
РИЗИЦИ ОД ЗАКАНИ И КОНЦЕПТОТ НА ЗАКАНИТЕ**

**SECURITY ISSUES AND CONTEMPORARY RISKS FROM THE
THREATS AND THE CONCEPT ON THREATS**

Abstract

The threats and the concept to the threats have changed to a such extent that Security Studies include within them risks ranging from the epidemics such as HIV/AIDS and environmental degradation, until to the security concerns related to direct violence, such as terrorism and inter-state conflict. The latter, which has dominated so much the discipline, such that during the Cold War it became synonymous of the Security Studies, it is currently a subfield of Security Studies, known as the Strategic Studies for the Safety of Contemporary Society.

As can be seen in contemporary Security studies, many Security researchers are of common opinion to achieve a common international consensus on the content of security that it has to do with the survivals toward the threats. On the other hand, what is most striking is that within this simple definition lies the complexity that will discover the security sciences from and will be discussed in the continuation of this scientific study in the field of Security, in the following you will also find alternative approaches toward security, approaches that offer different reference objects, various security tools, which show that past

¹ Doctorante në Fakultetin e Sigurisë në Shkup, 2019.

practices, instead of strengthening the security, they have been the cause of insecurity.

Key words: Security, security systems, threats, concept of threats, risks, strategies, protection,


*Security is the first obligation of a State*²

1. Fillet historike dhe kuptimi i sigurisë

Shoqëria njerëzore që nga zanafillat e para të mbijetësës njerëzore është përballuar me kërcënime të ndryshme dhe janë shkaktuar dëme të mëdha në njerëz dhe dëme të mëdha si shkaktar të vuajtjes së njerzimit. Shoqëria njerëzore u përballë me shumë luftra ku humbën jetën me miliona njerëz dhe kaloi shumë kohë për të kuptuar se vetëm bashkëpunimi dhe toleranca do të shpëtojë njerzimin. Nocioni *Siguri* rrjedh nga fjala latine *securitas* që do të thotë, pa shqetësime dhe preokupime, gjegjësisht shmangie nga pasiguria, evitimi nga kërcënimi dhe rrezikimi i pasigurisë, po ashtu përfshihet edhe mbrojtja e qytetarëve nga kriminaliteti, ekstrimizmi politik-religjioz, terrorizmi etj. Më e rëndësishmja në këtë kontekst është sigurimi i sistemit politik nga amriqtë e brendshëm. Nga ana tjetër, sipas një definicioni të reduktuar, “siguria është mënjanimi i të gjitha aktiviteteve që synojnë të rrezikojnë personat, rendin kushtetues, objektet apo hapësirën e caktuar”. Subjekte dhe organe të ndryshme angazhohen në punë të mbrojtjes së vlerave dhe të mirave të caktuara dhe secili prej tyre aplikon metoda dhe masa specifike veprimtaria ligjvënëse, masat represive etj).³ Siguria në kuptimin më të gjerë politik-juridik përfshin masat dhe aktivitetet e mbrojtjes nga rrezikimi i pavarësisë dhe integritetit të një vendi *shteti, kombi* dhe të rendit të brendshëm kushtetues dhe ligjor. Në rastin e parë flitet për sigurinë e jashtme, kurse në rastin e dytë për atë të brendshme. Sipas objektit të mbrojtjes dallohen:

² Michelle Alliot – Marie

³ Dr. Bashkim Selmani „Sistemet e sigurisë politike” faq.29-34. Universiteti parë privat „Fon”-Shkup 2009.



Më tej, nocioni i sigurisë së përgjishme përfshin mbrojtjen e të drejtave personale, të pronës, politike dhe të tjera, si dhe të lirive të qytetarëve nga kufizimet kriminalet përdorimit të tyre. Liritë dhe të drejtat personale përfshijnë mbrojtjen e jetës, të integritetit dhe të paceshëmërisë së personit, pastaj pacënueshmërinë e banesës, fshehtësinë e letrave dhe të mjeteve të tjera të komunikimit, lirinë e lëvizjes dhe të banimit dhe të drejtat e tjera personale dhe politike.

2. Siguria si funksion shtetëror dhe niveli më i lartë rrezikimit

Që të mund të flitet për sigurinë shtetërore, është e nevojshme të dimë se çka është shteti dhe cilat janë rreziqet e sigurisë që asaj i kërcënohen. Në këtë kuptim, kur është puna te rreziqet e sigurisë, do të bëhet fjalë për kërcënimin më të madh, e ky është agresioni. Shteti është forma bazë dhe më e rëndësishme e organizimit të çdo shoqëria klasore. Shteti është ai territor me banorët e saj, të cilën sundimtari e mban nën sundimin e vet si një pronë të tij. Në shumicën e gjuhëve të tjera edhe në shqip emërtimi për shtetin vjen nga latinishtja *status* nga konteksti *status rei Romanae*. E tillë është rrënja e fjalës frënge *etat*, italiane *stato*, angleze *state*, spanjolle *estado*, gjermane *Staat* etj. Është karaktërishtike se këto terma që shprehin dallimin e qartë të organizimit shtetëror nga prona feudale apo të shoqërisë në kuptim më të gjerë të fjalës paraqiten relativisht vonë: vetëm nga fillimi i shekullit XVI. Ndarja e qartë e kuptimit të shtetit kohësisht përputhet me periudhën e formimit të organizimeve shtetërore moderne në formën e monarkive absolute. Përgjatë një historie të gjatë të zhvillimit teorik dhe të mendimi filozofik-

shkencor për shoqërinë dhe politikën, janë bërë shumë përpjekje të shpjegohet dhe të kuptohet origjina dhe natyra e shtetit.

Kanë ekzistuar dhe ekzistojnë shumë teori, të cilat shtetin e shikojnë si shtrirje kuantitative të organizimit fillestar të familjes dhe të fisit; teoritë për origjinën qiellore të pushtetit shtetëror, të cilat veçmas kanë qenë të përhapura në mesjetë; teoritë objektive-idealiste të cilat te shteti shohin sendërtimin e frymës dhe idesë absolute, të shpirtit të popullit dhe njerëzimit, vlerat më të larta morale etj.; teoritë biologjiko-organike e shohin dhe e shpjegojnë shtetin si organizëm të rendit më të lartë, organet e të cilit kanë funksionin dhe marrëdhëniet të ngjashme me organet e njeriut dhe të qenieve të tjera të gjalla; teoritë e marrëveshjes shoqërore, të cilat kanë lulëzuar në shekujt XVII dhe XVIII si kritikë të teorisë feudale për origjinën qiellore të shtetit. Teoritë e forcës në variantet e shumta moderne shpjegojnë origjinën dhe natyrën e shtetit me vetë aktet e organizimit të dhunës, pushtimit dhe nënshtimit: grupet shoqërore të aftësuara më mirë për luftë të *armatosura me cilësi organizative ose luftarake* korrin fitore mbi grupet më të dobëta dhe organizojnë sundimin mbi ata, duke formuar kështu shtetin.⁴ Sot teoritë më të përhapura e trajtojnë shtetin si organizim që kryen një funksion të caktuar në kuadër të sistemit social, i cili edhe vetë paraqet një sistem të funksioneve komplementare dhe me varshmëri reciproke. Shteti është forma themelore e konstituimit të shoqërisë klasore, një organizim i veçantë i pushtetit publik, funksioni kryesor i të cilit është ruajtja dhe zhvillimi i rendit klasor, që domethënë të atyre marrëdhënieve prodhuese në të cilat mbështetet dominimi i klasës sunduese, ndërsa mjet themelor ka përdorimin ose kërcënimin me përdorim të mjeteve legjitime të dhunës fizike.⁵

3. Termi shtet përdoret në disa kuptime

Termi shtet përdoret me kuptime të ndryshme. Në kuptimin e ngushtë, me nocionin shtet nënkuptohet vetë aparati shtetëror, organizimi hierarkik i përbërë prej bartësve individualë dhe kolektivë të pushtetit shtetëror dhe nga të gjithë nëpunësit dhe zyrtarët që hyjnë në përbërje të organeve të ndryshme të tij.⁶ Në këtë kuptim, shteti është

⁴ Një shtet qeveriset më mirë nga një njëri i shkëlqyer se sa nga një ligj i shkëlqyer. (Aristotele)

⁵ Nëse Shteti është i fortë, ai na shtyp. Nëse ai është i dobët, na vdes.

⁶ Një shtet që zvogëlon subjektet e tij, duke i bërë instrumenta të bindura të projekteve të tij, ai nuk mund të bëjë gjëra të mëdha. (John Stuart Mill)

kundërvënie e drejtpërdrejtë e shoqërisë mbi të cilën ushtrohet ky pushtet. Por shteti është edhe subjekti themelor i marrëdhënieve ndërkombëtare. Me gjithë që vepron si forcë e jashtme e shoqërisë dhe qëndron mbi të, ai në fund të fundit është vetëm formë e konstituimit të një shoqërie klasore, i pandarë prej saj. Duke marrë parasysh këtë, për shtetin mund të flitet edhe në kuptim më të gjerë. Në një rast të këtillë, me shtet nënkuptojmë shoqërinë e tërë të përfshirë në një organizim shtetëror, pra jo vetëm aparatit shtetëror, por edhe territorin dhe banorët që janë nën pushtetin e shtetit. Shteti është edhe fenomen historik. Ai lind kur zhvillimi i forcave prodhuese të shoqërisë rrënon përfundimisht strukturën homogjene shoqërore të bashkësive të para primitive.⁷

4. Sistemet e organizmit shtetëror

Në çdo sistem të organizmit shtetëror ekziston dallimi ndërmjet organeve politike dhe atyre shtetërore tekniko-profesionale. Organet politike janë bartës të pavarur të disa prerogativave të pushtetit shtetëror. Ato marrin vendime politike, dmth. përcaktojnë orientimet dhe përmbajtjet e politikave shtetërore. Organet profesionale dhe ndihmëse administrative ushtrojnë pushtetin shtetëror vetëm në bazë të autorizimeve që tek ato i bartin organet politike. Ato janë instrumente të zbatimit të një politike të caktuar. Dallimi ndërmjet organeve politike dhe profesionale-administrative, ndërmjet organeve që vendosin politikisht dhe aparatit administrativ që zbaton vendimet e marra, merr kuptim të veçantë në organizimin demokratik të sistemit shtetëror, me ç'rast organet politike janë në përputhje me organet e zgjedhura përfaqësuese. Nga marrëdhëniet e vendosura në praktikë ndërmjet organeve politike dhe aparatit shtetëror, nga pavarësia më e madhe ose me e vogël e burokracisë shtetërore varet së tepërmi shkalla e demokratizimit të rregullimit shoqëror.⁸ Me *territorin shtetëror* si objekt sigurie në mënyrë organike është i lidhur edhe kufiri shtetëror. Kufiri shtetëror është i rëndësishëm edhe për sigurinë e brendshme dhe të jashtme,

⁷ Zhvillimi i forcave prodhuese është mbështetur mbi ndarjen e punës e cila gjithashtu, nga ana e saj, ka pasur rëndësi të madhe për zhvillimin e forcave prodhuese dhe për ndryshime afatgjata në strukturën e shoqërisë dhe të organizimit të saj të përgjithshëm. Nga këmbimi sporadik zhvillohen format e përhershme të lidhjeve ndërmjet punëve të ndryshme të fiset e ndryshme, kurse më vonë gjithnjë e më shumë edhe ndërmjet familjeve me lidhje të gjakut.

⁸ Kemi nevojë për liri për të penguar shtetin të abuzojë me pushtetin e tij dhe kemi nevojë për Shtetin për të penguar abuzimin e lirisë (Karl Popper).

pacenueshmëria e kufijve, incidentet kufitare, kontrabanda dhe trafiki-mi kufitar, migracioni ilegal, futja e bandave etj. Kufiri shtetëror është vija që shënjon se ku përfundon territori i një shteti dhe ku fillon territori i një shteti tjetër. Nëse bëhet fjalë për shtet me kufi detar, kufirin shtetëror në raport me detin e hapur e përbën vija e jashtme e ujërave territoriale. Hapësira e kufizuar në botë dhe teknologjia e shfrytëzimit të saj ka bërë që kufirin shtetëror ta përbëjnë edhe gjërat që bien drejt në tokë apo në sipërfaqen e ujit dhe shkojnë në thellësi të tokës, kështu që kufiri shtetëror ka përkufizuar jo vetëm sipërfaqet tokësore, por edhe ato ujore, hapësirën ajrore dhe thellësinë nëntokësore. Shkalla më e lartë e rrezikut për një shtet është agresioni. Çka është agresioni dhe kush mund të jenë agresorët? Marrë në përgjithësi agresioni është sulm, shkelje, çdo formë e dhunës. Në rastin tonë agresioni është sulm i paprovokuar i një ose më shumë shteteve mbi sovranitetin dhe integritetin territorial të shtetit tjetër, me qëllim të pushtimit territorial ose të ndërrimit të dhunshëm të rregullimit të brendshëm, ose për të arritur qëllime të tjera politike dhe plane të ngjashme, me të cilat rrezikohet pavarësia dhe sovraniteti ose tërësia territoriale e vendit të sulmuar.⁹ Më së shpeshti është sulm i armatosur dhe bëhet me përdorimin e forces ushtarake, por përfshin edhe çdo aksion të drejtuar kundër tërësisë territoriale dhe pavarësisë së shtetit tjetër, sikundër edhe paqes në botë. *Agresor* është shteti i cili në çfarëdo mënyre rrezikon pavarësinë, sovranitetin ose integritetin territorial të shtetit tjetër, respektivisht forcat e armatosura të të cilit sulmojnë një vend tjetër. Karta e OKB-së i jep të drejtë shtetit të sulmuar dhe bashkësisë ndërkombëtare që kundër agresorit të përdorë mjetet individuale dhe kolektive të vetëmbrojtjes dhe sipas të drejtës ndërkombëtare çdo shtet mund t'i kundërvihet me të gjitha mjetet dhe format e luftës që ka në dispozicion, por që nuk janë të ndaluara me të drejtën ndërkombëtare. E drejta ndërkombëtare mbështet mbrojtjen nga agresori duke i ofruar ndihmë edhe atyre qytetarëve të cilët në mënyrë të paorganizuar apo në çfarëdo forme tjetër u kundërvihen forcave të tjera dhe vjen deri te konflikti apo lufta e hapur.¹⁰

⁹ Alan Collins „Studime bashkëkohore të sigurisë faq.131.UET/Press, Tiranë,

¹⁰ Më së shpeshti është sulm i armatosur dhe bëhet me përdorimin e forcës ushtarake, por përfshin edhe çdo aksion të drejtuar kundër tërësisë territoriale dhe pavarësisë së shtetit tjetër, sikundër edhe paqes në botë.

5. Siguria shtetërore

Kur të definohet siguria shtetërore në kuadër të sigurisë kombëtare, nisemi nga fakti që ajo paraqet veprimtari të veçantë të organeve të veçanta dhe të caktuara në planin e mbrojtjes së rendit të caktuar shoqëror dhe politik. Vëllimi dhe kuadri i veprimtarisë më së shpeshti përcaktohet me kushtetutë dhe me ligje, ndërsa objektet e mbrojtjes janë baza mbi të cilat mbështetet rendi i caktuar shtetëror (p.sh. pronësia mbi mjetet e prodhimit, format e qeverisjes, rendi politik dhe kushtetues, sovraniteti kombëtar, respektivisht mbrojtja e rendit publik në tërësi). Zakonisht bëhet dallimi i sigurisë kombëtare në kuptim të ngushtë dhe në kuptim të gjerë. Me sigurinë kombëtare në kuptim të ngushtë zakonisht nënkuptohet veprimtaria që ka për qëllim të garantojë sigurinë personale dhe pronësore të përcaktuar me kushtetutë dhe ligje. Siguria në kuptim të gjerë përfshin veprimtarinë që ka për qëllim themelor mbrojtjen e bazave mbi të cilat mbështetet një rregullim i caktuar shtetëror. Nga kjo që del se del se detyrë kryesore dhe qëllim i këtyre organeve shtetërore zbulimi dhe pamundësimi i të gjitha aktiviteteve që janë të drejtuara në drejtim të rrezikimit ose të rrëzimit të dhunshëm të bazave të rendit shoqëror-politik dhe shtetëror. Një mënyrë e këtillë e dallimit të sigurisë buron nga mënyra e realizimit të mbrojtjes edhe të objekteve që merren nën mbrojtje, kështu që në këtë mënyrë theksohet vetëm aspekti funksional i nocionit siguri, ndërsa lihet me një anë fakti se shumë rrezikime të sigurisë personale-pronësore përmbajnë në vete edhe elemente të rrezikimit të bazës përkatëse të rendit shoqëror-politik.

Që këndej ndarjet e këtilla kanë vetëm vlerë relative. Punët e sigurisë shtetërore në kuadër të sigurisë kombëtare realizohen kryesisht përmes organeve përkatëse dhe shërbimeve siç janë: policia, shërbimi i zbulimit dhe kundërzbulimit dhe disa organe të tjera të drejtësisë dhe të prokurorisë. Më tej, me sigurinë shtetërore nënkuptohet përdorimi dhe aplikimi i metodave, masave dhe veprimeve nga organet, shërbimet dhe subjektet politike, me të cilët parandalohet, pamundësohet ose bëhen të parrezikshëm bartësit e veprimtarive që rrezikojnë shtetin. Fundja, me ligje dhe normativa të tjera janë caktuar organet, shërbimet dhe organizatat që janë të obliguara me kohë të zbulojnë, pengojnë ose të bëjnë të parrezikshëm personat ose grupet e organizuara në territorin e vet ose në botën e jashtme, të cilët përpiqen të rrezikojnë rendin publik, dmth. sistemin e sigurisë nacionale. Këto aktivitete të organeve përkatëse manifestohen në parandalimin e veprave penale të drejtuara kundër

shtetit, zbulimin e përgatitjes së këtyre veprave penale dhe parandalimin e kryerjes së tyre, zbulimin e veprave të kryera penale të kësaj natyre, kapja e kryerësve të tyre dhe dënimi i tyre nga organet e gjyqit. Përveç punës së organeve dhe shërbimeve të përmendura, faktor me rëndësi i sigurisë shtetërore janë masat dhe aktivitetet e organeve të shtetit dhe të sistemit të zbulimit, të cilët me aktivitetin e vet agjitacionin, propagandën dhe informimi ngushtojnë hapësirën për veprim bartësëve të veprimtarive të rrezikshme dhe forcojnë rezistencën e shoqërisë duke ngritur kulturën e sigurisë.

6. Definimi i sigurisë kombëtare

Forma, cilësia, organizimi dhe qëllimi i sigurisë së secilit shtet varet nga një numër faktorësh. *Siguria e një vendi është para së gjithash veprimtari sistematike. Në thelb, kjo është gjendje në të cilën është siguruar mbijetesa e baraspeshuar fizike, shpirtërore, shoqërore dhe materiale e personit dhe bashkësisë shoqërore në raport me individët dhe bashkësitë tjera shoqërore dhe natyrës.* Që të arrihet kjo, gjegjësisht që siguria të funksionojë si element immanent strukturor i shoqërisë, është e domosdoshme që secili shtet të përcaktojë politikën e sigurisë, e cila rrjedh nga gjendja e sigurisë. Gjendja e sigurisë është tërësi e elementeve rrezikuese të cilat ndaras dhe bashkërisht kanë ndikim në gjendjen e sigurisë dhe disponimin e njerëzve në një territor të caktuar, mjedis ose objekt në një kohë të caktuar. Në paraqitjen e veprimtarisë se kërcënimit të jashtëm dhe të brendshëm, është e nevojshme të njihen dhe njoftohen forcat, vatrat, objektet e sulmit, metodat dhe format e shprehjes të cilat realizohen nga kërcënuesit, si dhe gjendjet e konfliktit dhe krizës në epokat e caktuara, dhe rrethanat të cilat i shkojnë për shtati armiqve për realizimin e veprimtarisë rrezikuese.

7. Elementeve të cilët formojnë gjendjen e sigurisë

Në vlerësimin e elementeve të cilët formojnë gjendjen e sigurisë, është e domosdoshme të zbulohen tendencat e qëllimet e bartësve të veprimtarisë kanosëse, veç e veç. Kjo arrihet me krahasimin e shprehjes së rrezikshmërisë në periudhat e mëparshme. Shërbimet e sigurisë ofrojnë elemente për gjendje sigurie shteteve dhe organeve tjera të cilat kryejnë vlerësimin e sigurisë dhe qëllimet që duhen realizuar në situatë të caktuara. *Politika e sigurisë, në mënyrë të përgjithshme, duhet të ketë*

parasysh: ekzistencën e shtetit, ekzistencën kombëtare, vetëruajtjen fizike, integritetin territorial, pavarësinë politike pavarësinë dhe sovranitetin dhe cilësinë e jetës së qytetarëve. Me këtë kuptojmë: sigurinë e jashtme, sigurinë e mbrojtjes, sigurinë e jashtme dhe të brendshme ekonomike e financiare, sigurinë e brendshme. Por, kur është fjala për definimin e sigurisë së brendshme, dallohen siguria juridike, siguria publike si substitut i sigurisë personale ose grupe, si dhe siguria sociale. Ndërsa fushat që i përkasin sigurisë, janë ushtarake, politike, ekonomike pronësore, sociologjike dhe ekologjike.

8. Vlerat dhe faktorët e ndikimit

E gjithë kjo, në thelb, në thelb rrjedh, në këndvështrimin teorik, nga katër grupe të përgjithshme të vlerave, e ato janë: ekzistenca, integriteti territorial, pavarësia politike dhe cilësia e jetesës. Se çfarë do të jetë politika e përgjithshme e sigurisë së një shteti e jashtme dhe e brendshme, varet nga shumë faktorë, por mund të dallohen veçanërisht disa prej tyre: trashëgimia historike, pozita gjeopolitike para së gjithash nga aspekti i mjedisit përreth, pozita gjeostrategjike, zhvillimi ekonomik, resurset kadrovike-materiale, potencialet demografike, rregullimi administrativ shtet i përbërë konfederatë, federatë, shtet i thjeshtë apo unitar i centralizuar apo i decentralizuar, union, parashikueshmëria e caqeve, rregullimi shoqëror i shtetit forma e qeverisjes, forma e pushtetit, shtetëror apo forma e ndarjes së pushtetit, forma e sistemit politik dhe forma, e regjimit politik.¹¹ Në lidhje me këta faktorë, ekziston një lidhshmëri e posaçme me fenomenin e *kulturës së sigurisë* së popullatës së çdo shteti konkret. Kultura e sigurisë, është pjesë e kulturës së përgjithshme të personave, mjedisit ose shtetit të caktuar. Kjo është një tërësi e njohurive nga fusha e sigurisë, gjegjësisht vlerat dhe arritjet të cilat janë objekt i sulmit dhe mbrojtjes, metodat dhe format, si dhe bartësit e rrezikimit, të cilët janë persona, bashkësi dhe shoqëri të afta për zbulimin e metodave, formave dhe veprimeve të rrezikimit, si dhe bartësit e këtyre veprimeve, pa marrë parasysh ku dhe si ato shprehen. Ngritja e kulturës së sigurimit, arrihet me punë në artikullimin e vetëdijes së çdo personi. Me “edukimin” për siguri forcohet vetëdija dhe patriotizmi, si dhe bindja, të cilat formojnë bazën themelore për rezistencë gjegjëse ndaj veprimit të kundërshtarëve dhe armiqve të jashtëm

¹¹ Alan Collins „Studime bashkëkohore të sigurisë faq.131.UET/Press, Tiranë,

e të brendshëm. Begatimi i vetëdijes së personit, bashkësisë dhe shtresave më të gjera të shoqërisë mbi format, metodat dhe bartësit e veprimtarisë rrezikuese, bëjnë më të aftë që t'u kundërvihen konkretisht këtyre veprimtarive. Kuptohet, politika autonome e sigurisë të shteteve të veçanta duhet të ishte edhe në pajtim me Deklaratën e KB, mbi parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe marrëdhënieve miqësore dhe bashkëpunimit nga 24 Tetori 1970, në të cilën thuhet se: *“të gjitha shtetet duhet të përmbahen nga organizimi, ndihma, financimi, inkurajimi ose toleromi i aktiviteteve subversive dhe terroriste, të cilat kanë për qëllim ndërrimin e regjimit në shtetin tjetër”*¹²

9. Politika e sigurisë

Në frymën e qëndrimeve të më larta, politika e sigurisë duhet të ofrojë përgjigje ndaj pyetjeve të mbrojtjes së interesave dhe prioriteteve të qytetarëve, shoqërisë në fjalë dhe shtetit në përgjithësi, nga cilido lloji i kërcënimeve të jashtme dhe të brendshme, si dhe të parashikojë masa politike, ekonomike e ushtarake në këtë kuptim; ajo politikë duhet të jetë gjithëpërfshirëse në qëndrimin e saj për shkulljen e rrënjëve të konfliktit dhe jostabilitetit. Më këtë nënkuptojmë analizë të vazhdueshme të mjedisit siguries dhe kërkimit të mënyrës të bashkëpunimit aktiv e të barabartë, duke shmangur konfliktet, kërcënimet dhe aspiratat në kuptimin dyanësh (integrimi, bashkëpunim strategjik e partneritet, tendencat drejt sigurisë kolektive, e tjera). Në zbatimin e politikës së sigurimit, ekzistojnë disa faktorë. Në lidhje me këto, grupin e veprimeve mund ta përkufizojmë si masa të sigurisë së një shteti dhe organeve të tij, gjegjësisht institucioneve dhe shërbimeve të sigurimit. Masat e sigurimit janë aktivitete dhe veprime që ndërmerren nga organet shtetërore për realizimin e mbrojtjes së vlerave të cekura shoqërore. Të gjitha masat e sigurisë mund të ndahen në të përgjithshme dhe të veçanta, gjegjësisht speciale. Masat e përgjithshme të sigurisë janë ato që ndërmarrin organet shtetërore, ndërsa në forcat e armatosura komandat dhe shtabet, me të cilat krijojnë kushte të përshtatshme për mbrojtjen efikase të pasurive dhe vlerave shoqërore, dhe angazhimin e të gjithë subjekteve të shoqërisë ose kolektivit në kryerjen e obligimeve në fushën e sigurisë. Masa e sigurimit realizohet me aprovimin e akteve ligjore dhe akteve tjera të përgjithshme, me të cilat rregullohet kjo materie dhe

¹² Alan Collins „Studime bashkëkohore të sigurisë faq.131.UET/Press,Tiranë,

ushtrimi i obligimeve dhe detyrave të cilat përcaktohen në mënyrë normative. Kjo do të thotë, respektimi konsekuent i veprimeve, regjimit, disiplinës dhe rendit në raport me vlerat e mbrojtura.

Masat e veçanta - speciale të sigurisë, aplikohen nga shërbimet e sigurimit të cilat, duke u shërbyer me metodat, masat, veprimet dhe mjetet e veta specifike zbulojnë, përcaktojnë, luftojnë, ndërprejnë dhe përcjellin veprimtarinë e bartësve të aktiviteteve kërcënuese, duke kontribuar kështu në mbrojtjen e vlerave dhe pasurive të caktuara të personave, grupeve dhe shoqërisë. Me këto mbrohen vlerat themelore të çdo shoqërie konkrete dhe me këtë edhe më gjerë, në kuptimin e gjendjes rajonale, kontinentale dhe botërore. Interesat themelore të sigurisë janë pandashmërisht të ndërlidhura me vlerat themelore, ndërsa vlerat themelore janë: mbrojtja e jetës, të drejtave kushtetuese, lirive dhe sigurisë personale të qytetarëve; mbrojtja e pavarësisë dhe integritetit territorial duke u bazuar në barazinë e shteteve dhe popujve; mbrojtja e demokracisë dhe të drejtave njerëzore, mbrojtja e të drejtave njerëzore dhe civile, mbrojtja e të drejtave të popujve, grupeve fetare dhe pakicave kombëtare; mbrojtja e vlerave familjare dhe morale dhe sigurimi i vazhdueshëm i mjedisit jetësor për krijim të mirëqenies materiale dhe përparimit të përgjithshëm; Mbi këto, gjithsesi bazohen interesat themelore: mbrojtja e sistemit kushtetues; zhvillimi i marrëdhënieve të sigurisë me shtete tjera, duke udhëhequr politikë proaktive të sigurisë; parandalimi i konflikteve; krijimi i sigurisë kooperative dhe ruajtja e paqes botërore; pjesëmarrje strategjike në ekonominë globale; forcimi i pozitës ndërkombëtare dhe qasja në sistemet kolektive të sigurimit dhe mbrojtjes; përfshirje dhe pjesëmarrje aktive në asociacionet rajonale dhe organizatat ndërkombëtare, dhe mbrojtja e ambientit, me parandalim të degradimit ekologjike dhe shfrytëzim racional të resurseve natyrore. Për të pasur një zbatim adekuat dhe të suksesshëm të politikës së sigurisë, është e domosdoshme që secili shtet të ketë një sistem të ndërtuar dhe efikas të sigurisë kombëtare shtetërore.

Conclusion

Development of the international community, which is consist from the subjects *states*, interactively is completed with dynamic changes in political, material, spiritual, security and other fields, which has gained new dimensions and qualities in the development of international relations. Regardless of efforts to build better relations between

today's states, the contemporary world is found in a certain instability security. Despite all the positive developments, it can be said that the contemporary world is functioning in conditions and time of *armed peace*. In this sense, the study of all challenging aspects and the way of eliminating the preconditions that are threatening the security of states, have gained new scientific, professional and operational dimensions, including redefinition of the doctrine and strategy of action of security mechanisms and protection in preserving the fundamental values of society as well as the international community in general. Continuous technological development at the same time creates opportunities for various misuses that can serve to supervise human activities, which represents one of the forms of undemocratic degradation of the human personality, but also of social groups, as well as to the whole societies and the state communities. Security in international relations, and accordingly to it even the national security of each state, is still interpreted in different ways.

Recensentë:

Prof. dr. Bashkim Selmani

Dr. Mevludin Mustafi

Bibliografia

1. Dr. Bashkim Selmani & Dr. Mevludin Mustafi „Sistemet e sigurisë-Sistema Security”-Shkup , 2016
2. Altin Shegani, Les Juridictions d’Exception en matiere de Terrorisme, Etude Franco – Albaanise , Universite Montesquieu – Bordeaux IV , Bordeaux 2002.
3. Alexandar, Yonah.Terrorizmi i Lindjes së Mesme. Profile grupesh të Përzgjedhura (Middle East Terrorism. Selected Group Profiles). Uashington, D.C.,Instituti Çifutët për Çështjet e Sigurisë Kombëtare 1994.
4. Batt, Judy (ed.), The Western Balkans: moving on(Chaillot Paper no. 70),Paris, Institute for Security Studies, 2004.
5. Bashkim Dr.Selmani & Mevludin Dr.Mustafi „Sistemet e sigurisë-Sistema Security” Furkan ISM Shkup,2016
6. Bashkim Selmani ‘Juridiksionet e veçanta në fushën e Terrorizmit.Studim krahasues Shqipërië-Maqedoni 2004/2005, Tetovë.

7. Batt, Judy, The question of Serbia,(Chaillot Paper no. 81),Paris, Institute for Security Studies, 2005.
8. Batt, Judy (ed.), Is there an Albanian question?,(Chaillot Paper no. 107),Paris, Institute for Security Studies, 2008.
9. Blank, Stephen J. (ed.), Yugoslavia's wars: The problem from hell, Carlisle, Pa, Strategic Studies Institute, U.S. Army War College, 1995.
10. Clément, Sophia, Conflict prevention in the Balkans: case studies of Kosovo And the FYR of Macedonia (Chaillot Paper no. 30),Paris, Institute for Security Studies, 1997.
11. Delevic, Milica, Regional cooperation in the Western Balkans (Chaillot Paper no. 104),Paris, Institute for Security Studies, 2007.
12. Johnsen, William T., Deciphering the Balkan enigma: Using History to Inform Policy , Carlisle, Pa, Strategic Studies Institute, U.S. Army War College, 1995.
13. Kola, Paulin, The Search for Greater Albania, London, Hurst & Company, 2003.
14. Malcolm, Noel, Kosovo, A Short History, London, Macmillan, 1998.
15. Rrecaj, Besfort T., Kosova's right to self-determination and statehood, Pristina, 2006.
16. Tindemans, Leo (Ch.), Unfinished Peace, Report of the International Commission on the Balkans, Aspen Institute, Berlin, 1996.
17. Triantaphyllou, Dimitrios (ed.), What status for Kosovo,(Chaillot Paper no.50), Paris, Institute for Security Studies, 2001.
18. Van Meurs, Wim (ed.), Prospects and Risks Beyond EU Enlargement, Southeastern Europe: Weak States and Strong International Support, Opladen, Leske + Budrich, 2003
19. Alexandar, Yonah, Mishael S.Setman dhe Herbert M.Levine, red., ETA: Profili i një grupi.Transnational,2001.